

A NON-STRUCTURALIST APPROACH TO FOREIGN LANGUAGE LEARNING

EDMOND CANE

WANG CAIXIAO

School of European Studies, Beijing International Studies University

Abstract: *Linguistic research has progressed a lot in the last 3-4 decades. While expectation in earlier projects in artificial intelligence (AI) were limited to technical and associative collaboration with linguists, linguistic research is often in leading roles or has an equal share for research in AI, machine learning and Natural Language Processing (NLP). Research in Corpus linguistics has advanced tremendously. L2 teaching and language acquisition in children have seen significant developments. However, compared to the pace and achievements in AI, NLP and the applied linguistics and cognitive sciences, there seems to be a relative lag regarding the application of the latest research knowledge into L2 teaching. Evaluation of the classroom practice and the more general framework may reveal the need for development. The treatment below offers some examples from the application of some basic theses in the latest currents: Cognitive Linguistics and Constructive Grammar*

Keywords: *Cognitive Linguistics, Constructive Grammar, language teaching, core-based structuring*

MËSIMI I GJUHËS SË HUAJ MBI BAZA JO-STRUKTURALISTE

Abstrakt: *Kërkimet gjuhësore kanë përparuar shumë në 3-4 dekadat e fundit. Nëse më herët projektet në sferën e inteligjencës artificiale (IA) ishin kufizuar kryesisht me bashkëpunime sekondare me gjuhëtarët, sot shumë kërkime në fushën e IA, NLP (Natural Language Processing) apo edhe Machine Learning, kanë në qendër vetë gjuhëtarët. Teknologjia e korpuseve është zhvilluar përtej parashikimeve. Zhvillime të rëndësishme ka pasur edhe në mësimin e gjuhëve të huaja dhe në studimet e zhvillimit të gjuhës te fëmijët. Por, krahasuar me ritmet dhe arritjet në IA, NLP dhe shkencat aplikative, duket se ka një vonesë relative të aplikimit të dijeve më të fundit në kërkimet gjuhësore dhe konjitive. Një vlerësim në këtë prizëm, mund të reflektojë*

nevojën për një zhvillim thelbësor. Trajtimi më poshtë ofron disa shembuj nga aplikime të disa tezave bazë në rrymat më të fundit: Gjuhësia Konjitive dhe Gramatika Konstruktive

Fjalë kyçe: *Gjuhësia Konjitive, Gramatika Konstruktive, mësimdhënie e gjuhës, strukturim me bazë përdorimin*

1. Hyrje: Konteksti dhe kuadri teorik

Në përgjithësi ‘komunikimi’ mes shkencave të mirëfillta gjuhësore dhe praktikave të mësimin të gjuhës së huaj nuk ka qenë shumë i ngushtë. Rrymat kryesore teorike nuk e kanë pasur kontekstin e mësimin të gjuhës së huaj si burimin e tyre parësor. Nga ana tjetër, edhe praktikuesit, dmth., mësuesit e gjuhës së huaj, kanë qenë më të interesuar te niveli zbatues shkencor dhe jo te gjuhësia e përgjithshme. Megjithatë, ndikimi ka qenë i shumëfishtë për shumë arsye. Mësuesit janë formuar brenda një kuadri shkencor, që në një mënyrë apo tjetër ka qenë i formatuar bazuar në teoritë e përgjithshme. Trajtimi më poshtë tregon ndër të tjera që do të jetë e nevojshme që mësuesit të jenë më aktivë dhe më të përfshirë në zhvillimet në nivelet më të larta teorike të gjuhësisë së përgjithshme, të kuptojnë dhe të bëjnë vetë zgjidhjet e tyre duke i verifikuar dhe analizuar në praktikë. Përndryshe, mund të mbeten të ndikuar, pa e kuptuar vetë, nga teori gjuhësore që ndoshta janë të tejkaluara, ose që duke u analizuar, mund të rezultojnë jo të dobishme për të ndërtuar proceset e mësimin të gjuhës.

1.1 Korniza teorike: teoritë gjuhësore që janë bazë ose ndikojnë qasjet për mësimin e gjuhës

Strukturalizmi ishte një moment i rëndësishëm në historinë e gjuhësisë. Shpesh shihet edhe si hallka prej nga gjuhësia hyri në mënyrë të plotë në rrjedhat e kërkimit shkencor, si një shkencë e mirëfilltë, e larguar mjaftueshëm nga trajtimet spekulative filozofike, narrative, si dhe nga analiza kryesisht krahasuese-historike. Më tej, vijuan një sërë qasjesh që kishin në bazë strukturën, deri në shkallën më të lartë arritur me gjenerativizmin. Ka pasur evoluim të shpejtë të asaj që gjuhëtarët të ndryshëm konceptonin si struktura. Në planin teorik, gjuhëtarët kuptuan që duhet të shkojnë përtej trajtimit përshkrues të strukturave (strukturalizmi post-Sosyrian: shkolla e Pragës, shkolla e Kopenhagenit, shkolla amerikane). Chomsky (1965)

përcaktoi se synimi i kërkimit gjuhësor është që të arrijë të zhvillojë një model gjuhësor që të përmbushë tre nivelet e plotësisë dhe saktësisë

- Saktësinë vëzhguese – që jep në mënyrë shteruese të gjitha tiparet, aspektet që mund të konstatohen për strukturat gjuhësore dhe komponentë të tyre
- Saktësinë përshkuese – që ndërton sistemin apo informacionit strukturor analitik, zbulon dhe përcakton rregullat të cilat janë në themel të aspekteve dhe tipareve që ne konstatojmë.
- Saktësinë shpjeguese – informacioni në themel të strukturave, dhe që shpjegon mënyrën e procesimit për të prodhuar vetëm struktura gramatikore (gramatikalitet – siç shprehet Chomsky), rregullsinë dhe bazën e zgjedhjeve ndër strukturat alternative. Ky informacion përbën rrënjët më të thella të strukturës dhe ndër të tjera ka edhe fuqi projektive, parashikuese – domethënë, parashikon mënyrën e procesimit dhe zgjedhjet që bëjnë folësit në vijim në zgjedhjen dhe përpunimin e strukturave gramatikore

Qasja teorike gjenerativiste ka dominuar shkencat gjuhësore në 6 dekadat e fundit. Por tashmë është formësuar një pol tjetër teorik, po aq i fuqishëm dhe i pranishëm në gjuhësi të paktën në 20-30 vitet e fundit. Këto rryma marrin përsipër të ndërtojnë modele si është strukturuar dhe si funksionon gjuha, duke përmbushur të tre nivelet e saktësisë dhe plotësisë, por e bëjnë jo duke vënë strukturën në themel të modelit të tyre gjuhësor, por përdorimin gjuhësor, materialin konkret që përdorin folësit, prej nga ngrihen shkallë të ndryshme abstragimi dhe skema strukturore. Këto rryma me bazë përdorimin, propozojnë se strukturat e gjuhës formësohen mbi bazë të përdorimit të gjuhës dhe gjatë përdorimit të gjuhës. Ndër rrymat kryesore janë Gramatika Konstruktive (GK) dhe Gjuhësia Konjitive (GjK)¹.

¹ Gramatika Konstruktive (GK) i ka fillimet te Charles Fillmore (1967, 1977). Kjo teori u bë më e njohur veçanërisht pas viteve 1980. Në 1995, Goldberg përcaktoi një kornizë më të plotë teorike (Goldberg 1995), që referohet nga të gjithë si gur themeli i GK. Autorë të tjerë të rëndësishëm janë Willliam Croft, Richard Hudson, Hans Boas, Ronald Langacker, Martin Hilpert, Thomas Hoffmann, Stefan Gries, Holger Diesel, etj.

Gjuhësia Konjitive është gjithashtu një fushë e gjerë rrymash, ndoshta shkolla më e plotë përballë Gramatikës Gjenerativiste. Ndër autorët e mëdhenj janë Ronald Langacker, George Lakoff, Gilles Fauconnier, Marc Turner, Laura Janda.

Përveç dallimit thelbësor mes tyre, nëse e ndërtojnë modelin e funksionimit të gjuhës me bazë strukturën apo me bazë përdorimin, këto dy shkolla të kundërta kanë një kuadër të tërë dallimesh që rrjedhin nga bazat e tyre konceptuale të ndryshme. Në këtë artikull, do të vijoje trajtimi sipas shkollës teorike me bazë përdorimin. Shkollat teorike në njërin drejtim apo tjetrin, kanë pasur variantet e tyre aplikative - zbatimin e tyre shkencor (shkenca e zbatuar), përfshi edhe në qasjet teorike dhe praktike për mësimin e gjuhës.

1.2 Konceptimi për gjuhën sipas shkollës (ose shkollave) teorike me bazë përdorimin.

Përgjithësisht, shkollat teorike kanë disa koncepte bazë, të cilat janë në themel të trajtimeve në sferat e caktuara të strukturimit dhe funksionimit të gjuhës. Teoritë me bazë përdorimin nuk janë një shkollë e vetme. Brenda tyre ka zhvillime, modele dhe teza të ndryshme. Por në përgjithësi ato ndajnë mes tyre një sërë tezash themelore.

Në lidhje me formësimin e gjuhës, qasja strukturaliste e nis shpjegimin nga struktura, e cila vetë-zhvillohet mbi bazë të 'informacionit strukturor' që përmban, dhe kështu zhvillohet sipas këtij programimi, pavarësisht kushteve dhe mjedisit ky ndodh kjo rritje dhe ky zhvillim. Prandaj drejtimet që ndjekin shkollën strukturaliste në lidhje me mësimin e gjuhës së huaj përpriqen të ndjekin të njëjtën rrjedhë, pra duke nisur me strukturën pasi gjithë informacioni i nevojshëm që duhet të ketë folësi për të mësuar gjuhën është brenda strukturës

Në qasjet e drejtimit tjetër, me bazë përdorimin, strukturat e gjuhës ngrihen nga përdorimi, formësohen dhe zhvillohen gjatë rrjedhës së përdorimit. Pra baza e nisjes nuk është struktura, por përdorimi, rastet praktike gjuhësore dhe strukturat janë derivat, apo produkt i një procesi të gjatë që ndodh në mendjen e folësve. (Langacker 1987, Goldberg 1995, Hopper & Bybee 2001, Bybee 2006, Croft 2001). Sipas GK dhe GjK, fëmijët që mësojnë gjuhën e mëmës, ndodhen në një mjedis gjuhësor, prej nga ata thithin, akumulojnë përpunojnë zhvillojnë, dhe akumulojnë në vijimësi, raste të plota gjuhësore: sintagma të plota, pjesë fjalish, fjali, kontekste gjuhësore më të gjera, që depozitohen dhe

Gramatika Konstruktive dhe Gjuhësia Konjitive shihen si dy shkolla që kanë një masë të madhe mbivendosje, dmth, të përbashkët.

ruhen pjesërisht. Ky është bagazhi që shërben si bazë për të ushqyer në mënyrë graduale dhe të vijuar ngritjen e strukturave gjuhësore. Prandaj dhe strukturat e para gjuhësore ndër fëmijët nuk janë të plota, dhe janë kopje të zbehta të rasteve që fëmijët kanë vërejtur dhe ruajtur në kujtesën e tyre (Tomasello 2003, Bybee 2006, etj.)

1.2.1 Projektioni dhe 'transferimi' i këtij dualiteti në metodologjitë e kundërta në mësimin e gjuhës së huaj

a) *Qasjet tradicionale* kryesisht e nisin ndërtimin e gjuhës te studentët bazuar në strukturat, duke shpjeguar dhe ndërtuar strukturat, dhe kanë pritshmërinë që studentët të ndërtojnë raste gjuhësore konkrete bazuar në strukturat si abstragim skematik me potencial të madh gjenerues.

b) *Qasjet me bazë përdorimin* hasen në mënyrë empirike në shumë praktika më të hershme, për shkak se mësuesit, me intuitën dhe eksperiencën mësimore kishin kuptuar pamjaftueshmërinë e strukturave dhe kështu krijonin praktika konkrete, ilustrime, trajtime të gjalla, spontane, natyrale. Ato nuk kanë lindur në truall të zbrazët dhe janë në linja të ngjashme me intuitën dhe ekspertizën empirike të mësuesve. Orientimi më i organizuar teorik në dekadat e fundit e bën më të qartë strategjinë mësimore, më efektive. Këto zbatime nuk janë aplikuar në masë të gjerë në mësimin e gjuhëve të huaja por është domethënës fakti që formatimi i provimeve të njohura ndërkombëtare përkohet nga kjo filozofi: TOEFL, IELTS, provimet e Cambridge Esol (FCE, CAE, PCE). Duke filluar nga 2001, kjo është edhe korniza formale e referencave për gjuhët që njih dhe aplikon Këshilli i Europës, dhe shumë shpejt u bë Korniza e Përbashkët edhe për kontinentet e tjera: Amerikë, Azi, Australi e Afrikë². Është zhvilluar një paketë e plotë eksperte që është bërë kuadri i formimit dhe vlerësimit të mësuesve të gjuhëve, provimeve të gjuhës dhe vlerësimit të studentëve³

² Korniza njihet si *Common Framework of References for Languages* – shih Shih <https://www.coe.int/en/web/common-european-framework-reference-languages>; <https://www.coe.int/en/web/common-european-framework-reference-languages/level-descriptors#:~:text=The%20CEFR%20organises%20language%20proficiency,'can%2Ddo'%20descriptors>.

³ Shih <https://www.coe.int/en/web/common-european-framework-reference-languages/the-cefr-descriptors>. Institucioni profesional që zhvillon dhe monitoron

Disa koncepte të tjera teorike që njihen si pjesë e bërthamës teorike të GK dhe GJK do të trajtohen më poshtë në seksionin 2.

2. Zhvillimi aplikativ i qasjeve me bazë përdorimin: teza, modele, praktika

Ndërtimi i një mjedisi përdorimi. Bazuar në qasjet teorike, funksioni i mësuesit është të organizojë dhe zhvillojë një situatë ligjërimi, ku të lëvrohet masa e gjuhës, e cila organizohet nga mësuesi në mënyrë që të depozitohet në mënyrë të qëndrueshme të studentët. Është kjo masë përdorimi, (kontekste, situata, argumente), që ruhet në kujtesë të studentëve. Strukturat dalin prej kësaj mase konkrete, paragrafësh konkretë.

Që të jetë e tillë, kjo situatë përdorimi kërkon disa parakushte.

- Duhet të jetë konkrete, natyrale, funksionale. Problemi i madh që kanë qasjet tradicionale është organizimi i mësimeve fragmentare që nuk kanë ‘prekje’ apo lidhje personale te studentët, me personazhe të sajuar. Sigurisht, këto artifica, apo edhe fjalitë formale në ushtrimet gramatikore nuk mund të depozitohen në kujtesë.

- Ajo që përcjell mësuesi duhet të jetë ngarkesë konjitive e përballueshme, të mos ketë mbingarkesë.

- Duhet të jetë racionale në ngarkesën strukturore – të përmbajë vetëm ato struktura apo set strukturash që janë objekt i mësimit

- Argumenti dhe rastet, rrëfimi, faktet në fjali apo njësi fjalish duhet të jenë lehtësisht dhe favorshëm lidhur me njëra tjetrën. Një seri rrëfimi e lidhur në vetvete ka mundësi të ruhet në kujtesë ndërsa fjali dhe pjesë fragmentare kërkojnë punë të madhe nga studentët për t’u ruajtur.

Modele në përputhje me sa më sipër mund të jenë me shumicë dhe nuk duhen dhënë vetëm receta të kufizuara. Disa raste tipike që kemi aplikuar në BISU (Beijing International Study University) në fazat e fillimit të mësimit të gjuhës (shqipe) janë më poshtë

Situata personale e studentit (studentët meshkuj aplikojnë variantin mashkullor, dhe studentet variantin femëror – secili të vetën, situatën reale, gjë që nuk ka për ta harruar)

kornizën dhe standardet e gjithëpranuara është ALTE – *Association of Language Testers in Europe* – shih <https://www.alte.org/>.

Unë jam XX. Jam nga Jam 18 vjeç. Familja ime është në Mamaja ime është ___ vjeç. Ajo është _____. Babai im është ___ vjeç. Ai është _____. Kam një motër. Motra ime është _____ vjeç. Ajo është në shkollë. Vëllai im është _____ vjeç. Ai është në shkollë.

Përshkrimi i shtëpisë – që sjell një seri strukturash: folja kam në rastet pa kryefjalë, emra shoqëruar me numra si dhe shprehje vendore. Shtëpia ime është në G D, në rrugën XX. Shtëpia është larg nga qendra, 1 orë me tren.

Është një apartament, në një pallat, në katin e 9-të. Apartamenti ka 2 dhoma gjumi, 1 kuzhinë, 2 banja, një dhomë ndenje dhe një ballkon. Unë kam një dhomë. Dhoma ime ka 2 dritare, 1 derë, 1 krevat, 1 kondicioner, 1 TV, 1 kompjuter, 1 raft librash, 1 dollap rrobash, 1 karrike dhe 1 tryezë.

Në këtë situatë ka edhe një numër modest shprehjesh vendore. Shpesh ndiqet një strategji e tillë: në fillim jepet një dozë e lehtë me një numër rastesh që kanë në thelb një strukturë të synuar, dhe më pas vjen një rrëfim tjetër që bart një numër të madh me këtë strukturë dhe në forma më komplekse.

Një rast interesant është përshkrimi i rutinës që javën e parë ose të dytë të studentëve fillestare. Foljet janë direkt të kuptueshme dhe të qëndrueshme. Veta, numri janë pothuaj të parëndësishme pasi është monolog për veten, dhe do ishte një kosto e panevojshme të mbingarkohet studenti me informacion strukturor (që nuk hezitojnë ta bëjnë mësuesit tradicionalë). Një shembull jepet më poshtë

Rutina ime. Zgjohem nga gjumi në 06.30. Lahem, vishem, dhe dal nga shtëpia në 07.00. Shkoj në mensë dhe ha mëngjes. Në orën 8 pa 10 arrij në shkollë.

Mësimi fillon në orën 09.00. Kam 3 orë. Mësimi mbaron në orën 12.15. Shkoj në mensë dhe ha drekë. Shkoj në shkollë. Mësimi fillon përsëri në orën 13.10. Mësimi mbaron në orën 05.30 pasdite. Dal nga shkolla në 05.30 pasdite dhe kthehem në dhomë. Ndërrohem, lahem dhe pushoj.

Më pas, bëj detyrat, studjoj. Përfundoj detyrat në 8. Ha darkë në 8 dhe më pas shoh televizor ose dal shëtitje. Fle gjumë në 11.

Kjo situatë ndërthen strukturën e argumentit që vjen dhe rivjen në formë të thjeshtë, një numër foljesh bazë të thjeshta, si dhe rikthim te numrat, duke i vendosur në një kontekst natyral

Përshkrimi i Tiranës: ku futen në masë shprehjet parafjalore vendore

Te sheshi është Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës. Afër Universitetit është Akademia. Afër Akademisë është Presidenca. Përballë Presidencës është Pallati i Kongreseve. Afër Pallatit është Muzeu Arkeologjik. Afër Muzeut është Universiteti.

Përshkrimi i ditëlindjes, që ka si fokus jo thjesht foljet, por strukturën bazë të argumentit: [kryefjalë–folje–kundrinë]

XXB ka ditëlindjen. Ajo bëhet 19 vjeç. Shoqet dhe shokët i përgatisin një festë. Në orën ... mblidhen në restorant, afer universitetit. Kanë disa dhurata. Kanë edhe një tortë me çokollatë.

Shoqet dhe shokët këndojnë: Shumë urime për ty/shummë urime për ty/shumë urime XXB/ Shumë urime për ty. Pastaj urojnë: Gëzuar Ditëlindjen.

XXB pret tortën. Në kokë ka një kurorë të bukur. A luan në piano. C luan në pipa. B luan në kitarë. D kërcen. F as nuk kërcen, as nuk këndon. Ai shikon. Disa djem dhe vajza hanë tortë dhe pinë koka kola. Më pas, ata luajnë: një djalë pikturon një fytyrë dhe vajzat gjejnë kush është. Ose, një vajzë pikturon një fytyrë dhe djemtë gjejnë kush është.

Struktura e argumentit është bërthama e fjalisë. Jo vetëm që është pjesa që ndodh në mënyrë të thjeshtë ose komplekse në të gjitha fjalitë, dhe kryesisht në një format që mund të dallohet lehtë, struktura e argumentit është edhe baza që sqaron dhe qartëson gjymtyrët e tjera.

Shqipja paraqet edhe një problem të konsiderueshëm, pasi shpesh kryefjala nuk është e shprehur me mjetet tipike (emër, përemër etj.), por megjithatë është e pranishme nëpërmjet mbaresës së foljes (veta), dhe kjo sendërton kryefjalën në strukturën e argumentit. Kjo është gramatika natyrale që duhet prezantuar, dhe mund të bëhet me shumë eficiencë në prezantimet situacionale – në situata shumë të qarta ku studentët të kapin sa më shpejt dhe qartë strukturën bazë [kryefjalë–folje–kundrinë]

Për këtë arsye, rekomandohet që pas fazës së parë ku studentët ndërtojnë bazën minimale me një sasi përdorimi të konsiderueshme dhe një set modest strukturash, është mirë të vijohet më rrëfime që janë të favorshme për kujtesë të gjatë, të qëndrueshme, dhe që kanë një linjë që mban vetveten. Një shembull që ka disa tipare të tilla është seria për historinë e Skënderbeut, që për studentët e vitit të parë u prezantua pas

2-3 muajve të parë. Avantazhi është se ky rrëfim mund të ndërtohet me një fjalor modest që shpjegon vetveten. Gjithashtu, struktura bazë e argumentit mbetet përgjithësisht e qëndrueshme ose që mund të kuptohet menjëherë, pasi personazhet, veprimet, rrethanat e veprimit mund të merren lehtë me mend dhe ndjekin një rrjedhë të njohur. Një rast i tillë siguron një shpjegim të lehtë dhe ka garanci për kujtesë të gjatë që mund të rifreskohet, ristrukturohet dhe zgjerohet lehtësisht.

Një tjetër rast ideal janë poezitë apo këngët. Situata që sjellin është reale, konkrete dhe me ngarkesë të madhe konjitive dhe emocionale – është një argument që, pasi studentët e kanë mësuar, e kanë të lehtë ta mbajnë në kujtesë.

Këngët kanë një avantazh më tepër, pasi kanë një melodi që i ngjiz frazat në një linjë të vijueshme dhe kjo është garanci për kujtesë të qëndrueshme. Këngët janë përdorur për disa struktura specifike. Më poshtë vijnë disa ilustrime

Përdorimi i klitikëve që për shqipen është tipik dhe për studentët e huaj që nuk janë familjarizuar me këtë format, është diçka abstrakte, që pasi e kapin në një mësim, e harrojnë dhe kjo ndodh në një seri përpjekjesh. Edhe kur studentët në mësimin tradicional kanë punuar fort dhe i kanë kuptuar, janë gjendur disi më të dobët tek rastet e tjera të larmishme, ose kanë paqartësi. Ndërsa, situata konkrete, reale që nuk të shqitet nga mendja, e fikson në një lidhje specifike një strukturë të caktuar dhe vetëm atë.

Tek kënga “*Mirëmëngjes*” e A. Skënderajt për shembull, është rreshti:

1. *t’i them mirëmëngjes*

2. *Si t’ia them*

Në këtë kontekst, pasi është shpjeguar njëherë në mënyrë shteruese situata mes djalit dhe vajzës, nuk është e nevojshme t’ia rishpjegosh studentëve, pasi, kënga, linja e rrëfimit, video shoqëruese, zëri i Albanit janë përforcues dhe kontekst i pagabueshëm. Edhe nëse dobësohet njëri sinjal, janë të pranishëm sinjalet apo treguesit e tjerë dhe rrëfimi mbetet i plotë për një kohë të gjatë në kujtesë.

Një avantazh është se struktura e argumentit në të dy segmentet më sipër mbetet e njëjtë

[*djali – thotë – vajzës – mirëmëngjes*]

Pavarësisht se kryefjala (autori) mungon, bëhet automatikisht lidhje kryefjalë-folje dhe identifikohet markuesi vector i foljes si

shprehje e kryefjalës (Unë – djali në monolog). Qasja tradicionale strukturaliste është e orientuar të perceptojë strukturën formale:

Unë --- veta e parë njëjës

Them --- folje, veta I, njëjës

Ky format është një diskurs strukturor teorik dhe sigurisht nuk zë vend në mendjen e studentëve. Ndërsa për qasjen me bazë përdorimi, mësuesi duhet të japë rastet konkrete pa shpjegime teorike, në numër të bollshëm dhe studentët prej tyre abstragojnë gradualisht strukturat specifike sipas rastit. Për shembull, te seria e rrëfimeve për Skënderbeun, studentët marrin një masë të bollshme situatash:

Skënderbeu doli

Ai rrethoi kështjellën

Ai sulmoi

Turqit rrethuan kështjellën

Turqit sulmuan ...

Pra krijohet një seri që replikohet mjaftueshëm dhe krijon rregullsinë e nevojshme në mendjen e nxënësve. Strukturat dalin gradualisht prej rregullsisë së depozituar në kujtesë. Nëse në të kundërt, nuk tregohet kujdes dhe kujtesa bjeret, strukturat krijohen me vështirësi, krijohen struktura të mangëta, ose nuk krijohen.

2.1 Zhvillimi i shprehive të të folurit, skema konjitive që dalin nga praktika ligjëruese

Teza qendrore që strukturat dalin prej përdorimit ofron një perceptim të ndryshëm nga qasjet strukturaliste në mënyrë si lidh performancën dhe kompetencën, të cilat Chomsky i ndan në mënyrë absolute. Duke risjellë performancën si bazë ku ngrihet kompetenca, qasjet me bazë përdorimin risjellin rëndësinë që ka praktika – dhe kjo ka rëndësi të madhe në metodologjinë e të mësuarit dhe strategjitë didaktike. Kapaciteti për të folur krijohet dhe zhvillohet nga të gjitha përvojat dhe ndërveprimet ku është përfshirë folësi. Disa rrjedhoja indirekte nga kjo tezë vijojnë më poshtë.

- Nëse folësi përfshihet në praktika të varfëra – këto eksperiencia krijojnë tek folësi skema të varfëra
- Nëse këto praktika janë fragmentare, të sajua – do të humbin si ‘sheqeri në ujë’ dhe nuk depozitohen në kujtesë. Kjo është arsyeja që shumë përpjekje mësimore rezultojnë pa efekt dhe harrohen, dhe kështu progresi është tepër i ngadaltë dhe i mangët.

- Kur studentët në klasë ndodhen dhe përfshihen në praktika të mbushura me gabime dhe korrigjime, apo dështime – pikërisht këto janë skemat që zhvillohen në kujtesën dhe mendjen e studentëve

Sipas koncepteve të GK dhe GjK, skemat dalin nga eksperiencia ku këto trajta ndodhin dhe rindodhin rregullisht. Dabrowska (2014) thekson se sipas qasjes me bazë përdorimin, skemat apo konstruktet rrenjosen nëpërmjet përdorimit të përsëritur, në ligjërime apo në dëgjim. Përdorimi i njësive dhe lidhjeve të caktuara e përforcon sinjalin dhe kjo rrit gjasat që ky folës ta mbajë mend dhe ta përdorë këtë skemë në të ardhmen. Konteksti tipik për lindjen e skemave abstrakte është kjo linjë rregullsie, për të cilat sistemi konjitiv njerëzor është i përgatitur t'i kapë dhe t'i formësojë në skema apo konstrukte. Prandaj rregullsia është është në qendër të vëmendjes në organizimin e mësimi të gjuhës

Jam nga Pekini

Jam nga Tirana

ose

Ajo është mësuese

Ai është biznesmen

Ai është student

Ajo është profesore

Sa më sipër krijojnë rregullsitë ashtu si ndodhin në formën e tyre natyrale, që përfshin:

- i) Një masë të madhe të përbashkët, e cila ndodh dhe rindodh në këtë seri praktikash – kjo krijon rregullsinë skematike
- ii) Variacione tipike që e bëjnë këtë një situatë natyrale. Por, variacionet duhet të jenë në një masë modeste, përndryshe dëmtojnë fokusin dhe pengojnë perceptimin e masës dhe rregullsisë së përbashkët

Pjesë e rregullsisë është edhe konfigurimi me variacione brenda një skeme që përsëritet.

Babai im është 56 vjeç. Ai është inxhinier

Babai im është 62 vjeç. Ai është profesor

Mamaja ime është 54 vjeç. Ajo është biznesmene

Mamaja ime është 46 vjeç. Ajo punon në zyrë

Babai im është 61 vjeç. Ai punon në zyrë

Mamaja ime është 52 vjeç. Ajo punon në supermarket

Praktika më sipër sugjeron që rregullsitë mund të jenë të kombinuara: në strukturë dhe në funksion. Në këtë mënyrë koordinohen bashkë

Ajo është mësuese

Ajo punon në supermarket

Pasi funksionalisht, ato i përgjigjen të njëjtës pyetje dhe i përkasin të njëjtit kontekst.

Pra siç shihet, teoritë me bazë përdorimi kanë një orientim të fortë funksional dhe koordinojnë ngushtë strukturat dhe funksionin.

2.2 Koncepte të tjera që rrjedhin nga sa më sipër

Përdorimi siguron një kontekst të gjerë që përmban informacion gjuhësor dhe jogjuhësor, dhe ky informacion kontribuon në formatimin e strukturave gjuhësore (Diessel 2019), që është në përputhje edhe me konceptet e përgjithshme konjitiviste që strukturat gjuhësore rrjedhin prej përdorimit ose zbatimit të proceseve në sferën e përgjithshme konjitive (Bybee 2010: 1). Janë me dhjetëra detaje, efekte, raste në kontekstin ky ndodh një strukturë gjuhësore, që shpjegimi formalist strukturalist i injoron, dhe kështu studentët marrin një informacion tepër të varfër. Këto kontekste shoqëruese ruhen në kujtesë dhe janë pjesë e një strukture – prandaj folësit e një gjuhe janë aq të natyrshëm të pasur, spontanë. Kohët e fundit është theksuar shumë edhe fakti që informacioni dhe detajet asociative janë të një natyre multi-modale: efekte audio, vizuale të fytyrës, gjesteve, efekte emotive që shpesh janë më të forta se shprehjet ekspresive. Na ndodh shpesh që për një situatë të kaluar, kujtesa jonë mund të mos ketë regjistrimin e artikulimit ekspresiv (tekstual), por nuk fshihet lehtë se si jemi ndjerë në lidhje me këtë situatë. Këto janë ndjesitë që japin situatat natyrale si një poezi për shembull (në kurrikulën e BISU-t kemi përdorur poezi nga Mimoza Ahmeti, Xhevahir Spahiu, Naim Frashëri, Çajupi, Migjeni, Noli, etj.) dhe këto ndjesi emotive janë baza kryesore për kujtesën dhe prej nga formësohen strukturat e gjuhës në këto poezi).

Në literaturën e gjuhësisë konjitive një tezë qendrore është fakti që *kuptimi leksikor dhe gramatikor është enciklopedik*. Ky është një aspekt ku teoritë strukturaliste kanë qenë të pasukseshme, pasi në vend të kësaj pasurie në përmbajtje, japin një shprehje të thatë formalistike. Praktika ka treguar rëndësinë e një konteksti të pasur, të plotë si parakusht për suksesin e rrënjësor së strukturave.

Në formësimin e strukturave ka një rol të veçantë edhe informacioni sasior. Kjo shpesh bën dallimin e studentëve të huaj që mësojnë një gjuhë dhe folësve vendas, që e kanë gjuhën e mëmës, mësuar në habitatin natyral. Informacioni sasior për një strukturë apo për një tjetër bën dallimin dhe diferencon në përdorim cila strukturë është e përshtatshme në një situatë apo në një zhanër të caktuar. Asnjë lloj mësimi nuk do të arrinte të demonstronte aspektet sasiore të përdorimit të strukturave gjuhësore përveç praktikës natyrale të përdorimit të gjuhës mënyrë masive, natyrale siç është në përdorim normal, jo didaktik që aplikon metodologjia tradicionale.

2.2.1 Teza konstruktiviste: Gjuha është organizuar në konstrukte.

Këto janë njësitë themelore të gjuhës. Gjuha nuk është veçse një tërësi konstruktesh dhe gjithë informacioni fonologjik, leksikor e gramatikor është brenda konstrukteve si njësi bazë (Goldberg 1995, 2006, Langacker 1987, etj.). Kjo tezë shkon në drejtim të kundërt me tezat strukturaliste që e organizojnë gjuhën në module qartësisht të ndara: shtresa fonologjike, shtresa leksikore dhe shtresa gramatikore që organizon fjalët në ligjërim gjuhësor. Kuptohet qartë që ky konceptim i ndryshëm krijon dy metodologji krejt të ndryshme. Prova e vërtetësisë është sa të suksesshme janë në praktikat dhe eksperiencat mësimore.

Në mënyrë më konkrete, kjo nënkupton që gjuha nuk konceptohet si një set rregullat gramatikore që organizojnë fjalët dhe këto kanë më pas një veshje fonologjike. Sipas Gramatikës Konstruktive, nuk është e saktë të konceptojmë fjalë si njësi leksikore, pasi, në vend të kësaj, konstruktet konkrete kanë pjesën leksikore, gramatikore lidhur me këtë njësi konkrete dhe aspektin fonologjik të shkrirë në këtë njësi specifike. Në këtë mënyrë, Gramatika Konstruktive eliminon edhe një dallim tjetër të rëndësishëm strukturalist – nuk ka dallime thelbësore leksik – gramatikë, por ka konstrukte gramatikore dhe konstrukte leksikore që kanë një format të ngjashëm. Të dy llojet e konstrukteve janë ngjizje, çiftëzim i drejtpërdrejtë dhe i pandashëm i formës dhe përmbajtjes (Goldberg 1995, Croft 2001, Diessel 2019).

Në lidhje me sa më sipër, defekti kryesor i praktikave me bazë strukturalizmin është që në klasë prezantohet pjesa formale e strukturës dhe nuk ka vëmendje në lidhje konkrete specifike të strukturës formale me përmbajtjen funksionale. Në vend të paraqitjes modulare (ku semantika, gramatika etj., janë module më vete) në qasjet strukturaliste, Gjuhësia Konjitive propozon një prezantim të natyrshëm siç ndodh me

gjuhën e mëmës, ku nuk ndodh ndarja artificiale e konstruktit. Përkundrazi, mësuesi i sjell konstruktet në klasë të pandashme dhe synon ta konsolidojë këtë pandashmëri. Në rast se mësuesi e fillon prezantimin e njësive të reja gjuhësore në mënyrë të ndarë, është tepër e vështirë t'i ribashkojë dhe kjo është sfida më e madhe që bllokton ndërtimin e strukturave dhe kompetencës gjuhësore tek studentët.

Sipas Goldberg, gjuha është e gjitha konstrakte, nga fillimi deri në fund⁴. Për metodologjinë e mësimit të gjuhës, kjo nënkupton që gjithë informacioni që folësit, domethënë studentët, duhet të zhvillojnë për gjuhën, duhet të formatohet dhe konceptohet mbi bazë të konstrakteve specifike, leksikore apo gramatikore, dhe jo në fashën e leksikut nga njëra anë, që organizohet nëpërmjet fashës së rregullave sintaksore/gramatikore – që është qasja më bazë strukturën.

2.2.2 Teza: gjuha bën pjesë në kuadrin më të përgjithshëm të njohjes

Gjuhësia Konjitive e konsideron gjuhën si pjesë e kornizës më të përgjithshme të njohjes ndryshe nga Chomsky që e sheh si një sferë konjitive specifike, me tipare dhe ligje specifike funksionimi e strukturimi. Në vijim, edhe për gjuhën, janë mekanizmat e përgjithshme të njohjes dhe jo mekanizma specifike gjuhësore, që kushtëzojnë dhe përcaktojnë zhvillimin e gjuhës (në ndryshim të plotë me qasjen gjenerativiste). Në përputhje me këtë, organizimi i procesit mësimor përgjatë linjës strukturore është joefikas dhe i papërshtatshëm. Folësit mund t'a bëjnë të tyren materialin gjuhësor që shkëmbehet dhe strukturat e integruara brenda saj, nëse vendosen në një kontekst real, natyral dhe jo të sajuar – siç kanë zakonisht tekstet e gjuhës shqipe, që flasin për personazhe joreale (Mira, Beni, Tani) përfshirë në aktivitete që nuk arrijnë të ngacmojnë vëmendjen natyrale të studentëve. Një instruktor i gjuhës Python (gjuhë programimi) u shpreh se ai nuk prezanton gjuhën Python në përgjithësi. Kjo gjuhë është për të zgjidhur probleme. Fillimisht ju keni nevojë të keni një problem, dhe pastaj të përdorni këtë gjuhë për ta zgjidhur. Shumë materiale në tekstet tradicionale ose ato bazuar mbi strukturën nuk e kanë këtë metodologji dhe efektet ndjehen direkt te studentët. Kjo është e dukshme për shembull te numrat. Ky është një seksion interesant dhe ka metodologji të ndryshme për t'i trajtuar me studentët.

⁴ Goldberg 2006: 18 - "It's constructions all the way down!"

Nisur nga tezat dhe konceptet kryesore të qasjeve me bazë përdorimin, në eksperiencën në BISU kemi përgatitur kontaktet e nevojshme dhe mjediset reale ku gjenden numrat dhe ku folësit përdorin numrat. Fokusi ka qenë tek ato numra që kanë pasur lidhje me studentët: numrat e tyre të telefonit, që janë 18 vjeç, data e lindjes, etj. Një tjetër aspekt interesant është njohuria e ndërtuar mbi numrat, si veprimet aritmetike bazë, ose kombinime mbi rregullsi të caktuara, si për shembull numrat tek (1, 3, 5, 7, 9, 11, 13) ose seria e numrave çift (2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, etj.), numrat që plotpjesëtohen me 3 (3, 6, 9, 12, 15, 18, etj.) plotpjesëtohen me 5 (5, 10, 15, 20, 25), rregullsi të tjera: (23, 33, 43, 53, 63, ose 27, 37, 47, 57, etj.), numërimi prapa (10, 9, 8, 7, 6, 5, 4, 3, 2, 1), veprime aritmetike ($2+2=4$, $3+3=6$, $4+4=8$; etj.; $11=6+5$ / $7+4$ / $8+3$ / $9+2$; $9+7=..$; $9+5=..$ etj.).

Sa më sipër konkretizon edhe një parim të rëndësishëm konjitivist që kuptimi i njësive gjuhësore dhe lidhjeve të tyre ndërtohet mbi një informacion shumë të zgjeruar. Konkretisht, numrat nuk janë thjesht ajo shfaqje e sipërfaqshme [9 -> nëntë] por nënkupton një dije të gjerë, informacion për ato kontekste ku përfshihen. Ky informacion është faktik, specifik dhe deri individual – që ka kuptim për një folës të caktuar. Ky ka qenë një dallim mjaft i madh mes dijes që kanë pasur folësit e gjuhës mëmë dhe dijes që merrnin studentët në klasa tradicionale.

Një dizavantazh tepër i madh është kur mësuesi e lidh skemën numërore me gjuhën e mëmës të studentëve. Në këtë mënyrë, skemat solide të gjuhës mëmë bllokojnë formimin e skemave të gjuhës së re, ose, edhe kur formohen, mbeten gjithmonë dytësore nën lidhjet e forta të numrave në formatin e gjuhës primare.

Po kështu edhe shpjegimet e mësuesit janë një tjetër pengesë që bllokton formimin e skemave konjitive të studentët. Përkundër këtyre prirjeve tradicionale ose me bazë strukturat, rekomandohet që mësuesi të ofrojë kontekste përdorimi, të shumta në raste dhe në tipologji. Do të jenë studentët ata që gradualisht do të formësojnë konstruktet dhe skemat e abstraguara, mbi bazë të të cilave do të kenë një performancë aktive gjuhësore në lidhje me numrat⁵.

⁵ Për një trajtim më të plotë në lidhje me numrat si dhe me testimet e konceptuara mbi këtë qasje mund shihni Cane 2020

3. Përmbyllje

Ky artikull nuk mund të jetë një trajtim shterues i një informacioni aq të gjerë që trajtohet sot në qasjet e rëndësishme gjuhësore. Faktikisht, jo të gjitha aspektet teorike në rrymat gjuhësore kanë një rëndësi të konsiderueshme në mësimin e gjuhës së huaj. Përveçse duhet filtruar ai informacion që sjell një vlerë të shtuar te mësuesit, është e nevojshme të ketë një ndërveprim aktiv mes dy grupeve (mësuesve dhe gjuhëtarëve), që të përzgjedhin por edhe të shqyrtojnë dhe të diskutojnë çfarë bën të mundur një proces sa më efektiv dhe sa më të informuar nga dijet e sotme shkencore. Në një rast të tillë, nuk do ishte e papritur që të ketë edhe role të zgjeruara të palëve: domethënë, mësues që përfshihen në trajtime teorike gjuhësore thelbësore (jo vetëm në studime të zbatuara), si dhe gjuhëtarë që shikojnë më me vëmendje procesin e mëimit të gjuhës dhe msimdhënies, duke i përdorur si sfera për të kuptuar aspekte teorike ose për të vërtetuar apo zbatuar qasje të caktuara

BIBLIOGRAFIA

- Bybee, J. L. (2006). From usage to grammar: The mind's response to repetition., *Language*, 82(4), 711-733.
- Bybee, J. (2010). *Language, usage and cognition*. Cambridge University Press.
- Cane, E. (2020). Numeral schemas within cognitive framework: Their usage-based establishment and degrees of entrenchment. *Konińskie Studia Językowe*, 8(4), 409-433.
- Chomsky, N. (1965). *Aspects of the theory of syntax Special technical report no. 11* (No. NASA-CR-79495).
- Croft, W. (2001). *Radical construction grammar: Syntactic theory in typological perspective*. Oxford University Press on Demand.
- Dąbrowska, E. (2014). Recycling utterances: A speaker's guide to sentence processing. *Cognitive Linguistics*, 25(4), 617-653.
- Diessel, H. (2019). *The grammar network*. Cambridge University Press
- Fillmore, C. J. (1967). The case for case.
- Fillmore, C. J. (1977). The case for case reopened. In *Grammatical relations* (pp. 59-81). Brill.
- Fauconnier, G. & Turner, M. (2003). *The Way We Think*. New York: Basic Books.
- Goldberg, A. (1995). *Constructions: A Construction Grammar approach to argument structure*. . Chicago and London: Chicago University Press.

- Goldberg, A. E. (2006). *Constructions at work: The nature of generalization in language*.
Oxford University Press
- Hopper, P. J., & Bybee, J. L. (2001). Frequency and the emergence of linguistic structure. *Frequency and the Emergence of Linguistic Structure*, 1-502.
- Lakoff, G. & Johnson, M. (1980). *Metaphors we live by*. Chicago: Chicago University Press.
- Langacker, R. W. (1987). *Foundations of cognitive grammar: Theoretical prerequisites*, Stanford University Press.
- Pierrehumbert, J. (2001). Exemplar dynamics: Word frequency, lenition, and contrast. . In ed. by Joan Bybee and Paul Hopper, *Frequency and the emergence of linguistic structure* 137-157.
- Tomasello, M. (2003). *Constructing a Language: A Usage-Based Theory of Language Acquisition*, Harvard: Harvard University Press.